



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Br.No. 01 / 986	
DAT.DT. 03.08.2023	
PRISHTINË - A	

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 14 të Rregullores Nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me datë 7 gusht 2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Përmirësohet paragrafi 1, i vendimit KGJK.nr.379/2023, i datës 28 korrik 2023, për shkak të një lëshimi teknik, ku në vend të Jeton Krasniqi, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë – Dega Lipjan, duhet të jetë gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë – Dega Glllogoc, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet e njëjtë.
- II. Vendimi hyn në fuqi me 7 gusht 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.379/2023, të datës 28 korrik 2023, ka propozuar gjyqtarin Jeton Krasniqi, mentor për trajnimin praktik nga lëmia civile për gjyqtarin Astrit Gashi, me mandat fillestar në Gjykatën Themelore Prishtinë - Dega në Glllogoc.

Gjatë hartimit të vendimit të lartcekur, është lëshuar gabim teknik në paragrafin 1 sa i përket gjykatës në të cilën ushtron funksionin gjyqtari Krasniqi.

Me këtë vendim, përmirësohet lëshimi teknik sa i përket paragrafit të lartcekur ashtu që duhet të jetë Jeton Krasniqi, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë – Dega Glllogoc, pjesa tjetër e vendimit mbetet e pandryshuar.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Akademisë së Drejtësisë;
- Kryetares së Gjykatës Themelore Prishtinë;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit.